

United Nations
Nations UniesInternational Criminal Tribunal
for the former Yugoslavia
Tribunal Pénal International
pour l'ex-Yougoslavie

(IT-04-84-R77.1)

SHEFQET KABASHI

SHEFQET KABASHI

Akuzuar për shpërfillje të Tribunalit



Ish-anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)

Krimet për të cilat akuzohet:

Dy pika për Shpërfillje të Tribunalit (Rregulla 77(A)(i) dhe Rregulla 77 (G) të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit)

- Kabashi me vetëdije dhe qëllimisht, ndërhyri në ushtrimin e drejtësisë duke refuzuar kokëfortësisht t'u përgjigjet pyetjeve ose duke mos iu përgjigjur pyetjeve si dëshmitar para Dhomës dy herë në çështjen *Prokurori kundër Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*.

Aktakuza	5 qershor 2007, Urdhëresë në vend të Aktakuzës për shpërfillje. 18 shkurt 2008, Aktakuzë e ndryshuar
Paraqitja e Parë dhe vijuese	19 gusht 2011, shtyu deklarimin e tij; 26 Gusht 2011, u vetëdeklarua fajtor në të gjitha pikat e aktakuzës

TË DHËNA

FAZA PARAGJYQËSORE	
Dhoma Gjyqësore I	Kryegjykatës Alphons Orie, Gjykatës O-Gon Kwon dhe Gjykatës Howard Morrison
Avokat i Prokurorisë	Joanna Korner
Avokat i Mbrojtjes	Michael Karnavas

ÇËSHITJE QË KANË LIDHJE përnga zona gjeografike
HARADINAJ DHE TË TJERË (IT-04-84)

AKTAKUZA DHE AKUZAT

Në përputhje me Rregullën 77 të Rregullores së Procedurës dhe Provave, Tribunali mund të kryejë procese në lidhje me shpërfillje ndaj gjykatës. Për sa i përket shpërfilljes juridiksioni i Tribunalit nuk është përcaktuar shprehimisht në Statut. Mirëpo është vërtetuar definitivisht se Tribunali zotëron kompetencë të vetvetishme që buron prej autoritetit të vet ligjor, për të mundësuar mospengimin e ushtrimit të juridiksonit të vet përcaktuar shprehimisht në Statut dhe për garantimin e detyrave të veta themelore

gjyqësore. Duke qenë gjykatë ndërkombëtare penale Tribunali zotëron kompetencën e vetvetishme përkundrejt veprimeve ndërhyrëse ndaj ushtrimit të drejtësisë. Rrjedhimisht kushdo që me vetëdije dhe qëllimisht ndërhyr ndaj ushtrimit të drejtësisë prej Tribunalit, mund të shpallet fajtor për shpërfillje të Tribunalit.

Më 5 qershor 2007, Dhoma Gjyqësore lëshoi një urdhëresë në vend të aktakuzës kundër Kabashit në lidhje me refuzimin për t'iu përgjigjur pyetjeve si dëshmitar në çështjen *Prokurori k. Ramush Haradinajt, idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt*. Dhoma Gjyqësore vendosi ta procedonte vetë çështjen dhe i kërkoi dëshmitarit të paraqitej më 7 qershor 2007. Dëshmitari nuk u paraqit në gjyq më 7 qershor 2007 dhe u kthye në Shtetet e Bashkuara.

Më 1 nëntor 2007 Dhoma Gjyqësore e urdhëroi Kabashin të paraqitej për dhënie dëshmie nëpërmjet videokonferencës nga Shtetet e Bashkuara më 20 nëntor 2007. Dëshmitari u paraqit përmes videokonferencës dhe refuzoi të dëshmonte.

Më 11 dhjetor 2007, Dhoma ia referoi çështjen Prokurorisë për hetim të mëtejshëm dhe procedim penal, dhe udhëzoi Prokurorinë që të hetonte sjelljen e Kabashit duke qenë se kishte arsye të besonte se dëshmitari kishte kryer shpërfillje më 20 nëntor 2007.

Më 18 shkurt 2008 Dhoma Gjyqësore autorizoi Prokurorinë që të ndryshonte aktakuzën.

Kabashi u akuzua për:

- Dy pika për Shpërfillje të Tribunalit (Rregulla 77(A)(i) dhe Rregulla 77 (G) e Rregullores së Procedurës dhe Provave)